



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.131, datë 02.06.2022

PËR
“PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT ME PËLQIM NË
POZICIONIN E PROKURORIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 90 pika 2, të “Kodit të Procedurave Administrative”, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 5 pika 3 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të përfundojë procedurën e transferimit me pëlqim për plotësimin e vakancës së përkohshme, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, filluar mbi bazën e vendimit Nr. 99 datë 19.05.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më 02.06.2022.

KRYETARI

Alfred Balla

